

## Termet e Referencës

Ekspert/e lokal/e për zhvillimin e një plani të menaxhimit të emergjencave  
(Procedura standarde të veprimit, të cilat do të udhëzojnë stafin e HANDIKOS si të veprojnë në raste  
emergjente)

## HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

### I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME RRETH PROJEKTIT

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë Kosova/o është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights - H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDASida). Përmes këtij projekti, HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

### II. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për zhvillimin e një plani të menaxhimit të emergjencave (procedura standarde të veprimit, të cilat do të udhëzojnë stafin e HANDIKOS si të veprojnë në raste emergjente). Eksperti/ja fillimisht do të jetë përgjegjës/e për zhvillimin e planit si dhe më pas të ofrojë një trajnim 1 një-ditor për stafin e HANDIKOS me qëllim prezantimin mbi zbatimin dhe përdorimin e këtij plani, i cili plan duhet të jetë në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret dhe praktikat më të mira në gatishmëri për emergjenca.

### III. KUALIFIKIMI

Kandidati duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Kualifikime të avancuara në menaxhimin e emergjencave, sigurinë publike, menaxhimin e fatkeqësive ose fusha të ngjashme;
- Përvojë e dëshmuar në zhvillimin e planeve emergjente dhe fasilitimin e trajnimeve të ngjashme;
- Aftësi të mira analitike dhe të dokumentimit.

#### IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Kryerja e një vlerësimi të plotë të rrezikut për të identifikuar emergjencat e mundshme që mund të ndikojnë në HANDIKOS;
- Zhvillimi i një plani të detajuar të menaxhimit të emergjencave që përfshin parandalimin, gatishmërinë, reagimin, rimëkëmbjen dhe strategjitë e zbutjes/ për dy objektet e HANDIKOS (Qendra e Resurseve Burimore në Veternik dhe zyret në Dardani);
- Krijimi i materialeve të trajnimit dhe fasilitimi i trajnimit për stafin për të prezantuar planin e emergjencave;
- Ofrimi i mbështetjes dhe konsultimit të vazhdueshëm gjatë fazës së zbatimit të planit të menaxhimit të emergjencave;

#### V. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS.

Angazhimi do të bëhet gjatë muajit nëntor 2024 në bazë ditore, ku do të përfshihet:

Detyra	Kohëzgjatja
Zhvillimi i planit të emergjencave (procedurave standarde të veprimit, të cilat do të udhëzojnë stafin e HANDIKOS si të veprojnë në raste emergjente)	7 ditë
Fasilitimi i trajnimit mbi prezantimin e planit të emergjencave për stafin e HANDIKOS	1 ditë
<b>Totali i ditëve</b>	<b>8 ditë</b>

#### VI. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe dorëzimit të dokumentit të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

*HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.*

## VII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologji e punës për këtë angazhim ose shembuj të angazhimeve të mëparshme të natyrës së ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org)  
cc: [nora.simitciu@handi-kos.org](mailto:nora.simitciu@handi-kos.org)

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për: Ekspert/e për zhvillimin e një plani të menaxhimit të emergjencave

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 03/11/2024, ora 17:00.

**Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!**

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk është nën hetime;**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual** — **PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.